



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. 963 prot.

Kavajë, më 23 03 2021

VENDIM

Nr. 09, datë 23 03 2020

“PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TE PLANIT TE DETYRUAR VENDOR PER ZONEN E RE PER ZHVILLIM NR.1 , NJESIA ADMINISTRATIVE KAVAJE, BASHKIA KAVAJË”.

Mbështetur në nenin 8 , pika 2 , neni 9 , pika 1/1 , shkronja “b” dhe nenit 23 , pika 14 e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr.9 , datë 16.12.2019 , të Këshillit të Ministrave , Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 13 dhe 25 të Ligjit Nr.107/2014 , datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit ”, i ndryshuar , të Vendimit Nr.887 , datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e PdyV , si dhe procedurës së përshpejtuar së miratimit të Lejeve të Zhvillimit / Ndërtimit , në rastet e fatkeqësisë natyrore” , të Vendimit Nr.64 , datë 29.01.2020 “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Kavajë , Bashkia Kavajë , dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese të zonës nr.1 Kavajë” , të Vendimit Nr.686 , datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave , “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” , të ndryshuar , Të vendimit nr.27 datë 23.02.2021 të Këshillit Bashkiak Kavajë ,

Vendosi :

1. Miratimin e Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim , Zona I Njësia administrative Kavajë , në funksion të procesit të rindërtimit , sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi , pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm :

- a) Dokumenti i Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim , Njësia administrative Kavajë , Bashkia Kavajë.
- b) Hartat dhe Skicat përkatëse.

2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e vendimit dhe dokumentat shoqëruese të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 ditëve nga data e miratimit të tij , sipas ndryshimeve të miratuara.

3.Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Tërritorit.

KRYETARI I BASHKISË

REDJAN KRALI

